



*Prishtinë, 30 shtator 2020*

## **KOMUNIKATË**

**nga**

### **SEANCA E VII PËR KËTË VIT, E BORDIT TË RREGULLATORIT PËR ENERGJI**

Sot , me 30 shtator 2020, Bordi i Rregullatorit për Energji, ka mbajtur seancën e shtatë (VII) me radhë për këtë vit.

Në këtë seancë është miratuar Rregulla për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) për kryerjen e aktiviteteve të ndërlidhura me bashkimin e tregut dhe operimin e tij. Kjo rregull përcakton kushtet dhe procedurat për përcaktimin, nga Rregullatori, të këtij operatori në Republikën e Kosovës si dhe përkufizon detyrat të cilat do t'i kryej ky operator në lidhje me procesin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike. Miratimi i kësaj rregulle ka një rëndësi të veçantë në përshtetimin e funksionalizimit të tregut të përbashkët të energjisë në mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë.

Bordi po ashtu ka miratuar kërkesat e 7 aplikuesve për ndërtimin e gjithsej 160kW kapacitete gjeneruese për vet-konsum nga panelet solare në komunën e Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës.

Në këtë seancë është aprovuar edhe kërkesa e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Sh.a për vazhdimin e Licencës për prodhim të energjisë elektrike nga TC "Kosova A" edhe për një vit si dhe kërkesa për Licencë për furnizim me shumicë (tregtim) me energji elektrike e ndërmarrjes "Bindi Integrated Services" sh.p.k..

Pjesë e shqyrtimit dhe miratimit të Bordit në këtë seancë ishte edhe amendamenti i Metodologjisë së Taksave të Kyçjeve në Rrjetin e Transmetimit dhe kërkesa e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST -KOSTT) për derrogimin e Bilancit Afatgjatë të Energjisë Elektrike dhe Planit të Adekuacisë së Gjenerimit.

Si zakonisht në seancat e Bordit, edhe sot, janë shqyrtuar edhe disa ankesa të konsumatorëve si dhe çështje të tjera që ndërlidhen me funksionimin e Zyrës së Rregullatorit.

*Të gjitha vendimet e Bordit të ZRRE publikohen në faqen zyrtare [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).*